

VENDIM
Nr.20, datë 4.5.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “

me sekretare Brunilda Bara, në datë 6.11.2006, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.40/10 Akti që i përket:

KËRKUES: NJË GRUP DEPUTETËSH TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË (jo më pak se një e katërta e deputetëve), përfaqësuar nga Spartak Braho, me autorizim.

NJË GRUP DEPUTETËSH TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË (jo më pak se një e pesta e deputetëve), përfaqësuar nga Spartak Braho, me autorizim.

SUBJEKT I INTERESUAR: KUVENDI I SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Lulzim Lelçaj e Riçard Marku, me autorizim.

OBJEKTI: 1. Zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe subjektit kushtetues në konflikt (jo më pak se një e katërta e deputetëve), duke shpallur si antikushtetues:

a) vendimin nr.60, datë 27.09.2006 të Kuvendit të Shqipërisë “Për mosmiratimin e objektit të kërkesës së 35 deputetëve për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar për verifikimin e lidhjeve nepotike, konfliktin e interesit dhe përfitimeve pasurore që rrjedhin prej tyre për Kryeministrin, familjarët dhe të afërmit e tij”;

b) vendimin nr.59, datë 18.09.2006 “Për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar për verifikimin e pasurive, lidhjeve nepotike dhe konfliktit të interesave të zyrtarëve të lartë të institucioneve kushtetuese dhe publike”.

2. Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.59, datë 18.09.2006 të Kuvendit të Shqipërisë “Për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar për verifikimin e pasurive, lidhjeve nepotike dhe konfliktit të interesave të zyrtarëve të lartë të institucioneve kushtetuese dhe publike”.

Një grup deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë, me cilësinë e dyfishtë të subjektit legjitimues për një gjykim kushtetues (jo më pak se një e katërta e deputetëve dhe jo më pak se një e pesta e tyre) i ka paraqitur Gjykatës Kushtetuese dy kërkesa, me objekt të dallueshëm nga forma, por të njëjlojtë në përmbajtje.

Në bazë të neneve 131, shkronjat “c dhe ç”; 134/1, shkronja “c” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 54, 55 dhe 56 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, kërkuesi ka inicuar, nga njëra anë, një gjykim të karakterit kushtetues për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet pakicës parlamentare dhe Kuvendit të Shqipërisë dhe, nga ana tjetër, një gjykim për kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së normës juridike, duke parashtruar pretendimet e tij në këto drejtime kryesore:

- Një e katërta e deputetëve përbën subjekt kushtetues, të cilit vullneti i shumicës parlamentare nuk mund t’i kufizojë ushtrimin e kompetencës kushtetuese për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar. Kërkesa e pakicës parlamentare ka pasur për objekt hetimin parlamentar për një çështje me natyrë të përveçme, për atë të pasurisë së Kryeministrit dhe jo për hetimin e gjithçkaje dhe për çdo gjë.

- Kuvendi, me vendimin nr.60, datë 27.9.2006, nuk ka miratuar kërkesën e një të katërtës së deputetëve për ngritjen e komisionit hetimor, duke arsyetuar se shkak ligjor për refuzimin e saj ka qenë objekti i njëjtë dhe tërësisht i ezauruar me vendimin nr.59, datë 18.6.2006.

- Të dyja vendimet e Kuvendit, që përbëjnë dhe bazën për fillimin e këtij gjykimi kushtetues, kanë cenuar në thelb të drejtën kushtetuese të një të katërtës së deputetëve, duke shkaktuar mosmarrëveshje kompetencash ndërmjet pushtetit të pakicës parlamentare dhe Kuvendit të Shqipërisë.

- Në funksionet kushtetuese të Kuvendit nuk përfshihet verifikimi i pasurive të ndokujt, përderisa sipas ligjit ka organe të pavarura dhe të specializuara që e ushtrojnë këtë detyrë. Paqartësia e objektit të hetimit të komisionit parlamentar të ngritur nga Kuvendi është në kundërshtim me nenin 77/2 të Kushtetutës, si dhe me vendimin nr.18, datë 14.5.2003 të Gjykatës Kushtetuese.

- Ngritja e komisionit hetimor parlamentar nuk është bërë mbi bazën e ekzistencës së një çështjeje të veçantë, por të disave të tilla, të cilat kanë të bëjnë me verifikimin e pasurisë, lidhjeve nepotike dhe me konfliktin e interesave. Në rastin e dhënë, çështja nuk ekziston, por ajo kërkohet të zbulohet.

- Rrethi i subjekteve të përfshira në objektin e hetimit të komisionit hetimor del jashtë funksionit të kontrollit parlamentar. Hetimi parlamentar shtrihet edhe mbi funksionarë të lartë, të cilët janë hetuar më parë për të njëjtën çështje.

- Objekti i hetimit parlamentar shtrihet dhe për një periudhë kohore kur nuk ekzistonte ligji dhe as përkufizimi ligjor për verifikimin e pasurive, lidhjeve nepotike dhe për konfliktin e interesave.

Përfaqësuesi i subjektit të interesuar kërkoi rrëzimin e të dyja kërkesave, duke parashtruar pretendimet e tij në këto drejtime kryesore:

- Mosmarrëveshja e kompetencës ndërmjet pakicës dhe shumicës parlamentare nuk është me natyrë kushtetuese, sepse pakica dhe shumica parlamentare nuk përbëjnë pjesë pushtetesh të ndryshme, por secila i përket të njëjtë pushtet, atij legjislativ.

- Kërkuesi nuk ka evidentuar formalisht llojin, numrin dhe datën e aktit të Kuvendit, nga i cili mund të ketë lindur mosmarrëveshja e kompetencës ndërmjet pushteteve.

- Vendimi i Kuvendit nr.59, datë 18.9.2006 nuk përfshihet në kategorinë e akteve normative, në kuptim të nenit 131, shkronja “c” të Kushtetutës.

- Objekti i kërkesës të një të katërtës së deputetëve për krijimin e komisionit parlamentar për hetimin e Kryeministrit ka qenë i njëjtë dhe i ezauruar plotësisht me vendimin nr.59, datë 18.9.2006 të Kuvendit, i miratuar para vendimit për refuzimin e kërkesës së pakicës parlamentare.

- Shumica parlamentare, duke zgjeruar rrethin e subjekteve që do t’i nënshtrohen hetimit parlamentar, nuk ka disponuar mbi objektin e kërkesës së pakicës parlamentare. Zgjerimi i rrethit të këtyre subjekteve i shërben më mirë luftës kundër korrupsionit, si dhe krijon mundësinë e grumbullimit të shumë informacioneve për të rritur masat për eliminimin e shkaqeve që e favorizojnë këtë fenomen negativ të shoqërisë.

- Çështja që përbën objektin e hetimit në komisionin e ngritur nuk është një çështje e zakonshme, por një çështje e veçantë.

- Periudha kohore që është parashikuar të kontrollohet nuk ka rëndësi thelbësore për çështjen, sepse në Kushtetutë dhe në aktet e tjera ligjore nuk ka ndonjë dispozitë që të kufizojë hetimin parlamentar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesin e kërkuesit, përfaqësuesin e subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Kuvendi i Shqipërisë, mbi propozimin e deputetëve të shumicës parlamentare, me vendimin nr.59, datë 18.9.2006, ka miratuar ngritjen e komisionit hetimor parlamentar për verifikimin e pasurive, lidhjeve nepotike dhe konfliktit të interesave të zyrtarëve të lartë të institucioneve kushtetuese dhe publike, si dhe të personave të lidhur me ta, për periudhën 1992-2006.

Me vendimin nr.60, datë 27.9.2006, Kuvendi ka refuzuar kërkesën e deputetëve të pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor për verifikimin e lidhjeve nepotike, konfliktin e interesit dhe përfitimeve pasurore që rrjedhin prej tyre për Kryeministrin, familjarët dhe të afërmit e tij, me arsyetimin se objekti i kërkesës së mësipërme ka qenë i njëjtë dhe tërësisht i ezauruar me objektin e vendimit nr.59, datë 18.9.2006.

Një grup prej 30 deputetësh të Kuvendit, me cilësinë e subjektit të legjitimuar (jo më pak se një e pesta e deputetëve), në bazë të neneve 124/1; 131, shkronja “c” dhe 134, pika 1 shkronja “c” të 1380

Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe ka kërkuar shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.59, datë 18.9.2006 të Kuvendit të Shqipërisë “Për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar për verifikimin e pasurive, lidhjeve nepotike dhe konfliktit të interesave të zyrtarëve të lartë të institucioneve kushtetuese dhe publike.

Gjithashtu, një grup prej 36 deputetësh të Kuvendit, me cilësinë e subjektit kushtetues në konflikt (jo më pak se një e katërta e deputetëve), në bazë të neneve 77; 131, shkronja “ç” të Kushtetutës dhe të neneve 54, 55 dhe 56 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i është drejtuar kësaj Gjykate me një tjetër kërkesë, me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe pakicës parlamentare dhe shpalljen si antikushtetues të dy vendimeve të sipërcituara të Kuvendit.

Gjykata Kushtetuese konstaton se kërkesa me objekt kontrollin e kushtetutshmërisë së normës juridike ka natyrë të njëjtë, në substancë dhe në argumentet e paraqitura; me njërin nga pretendimet e parashtruara në kërkesën me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës, paraqitur nga jo më pak se një e katërta e deputetëve të Kuvendit. Për këtë arsye dhe me qëllimin e arritjes së efektivitetit të gjykimit, ajo i bashkon kërkesat e sipërpërmendura në një çështje të vetme dhe ia nënshtrohet ato shqyrtimit kushtetues. Ky bashkim nuk e pengon Gjykatën Kushtetuese të vlerësojë dhe të përcaktojë qëndrimin e vet ndaj pretendimeve të ngritura dhe ndaj çdo argumenti në mbështetje të tyre të paraqitur nga kërkuessit.

Grupi prej jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit, në cilësinë e subjektit të legjitimuar, ka arsyetuar për papajtueshmërinë me Kushtetutën, posaçërisht me nenin 131, shkronja “c” të saj, të vendimit nr.59, datë 18.9.2006 të Kuvendit të Shqipërisë. Përfaqësuesi i subjektit të interesuar e ka mbështetur mbrojtjen e vet në argumentin e mungesës së juridiksionit kushtetues për shqyrtimin e vendimit të sipërcituar të Kuvendit, për shkak të karakterit individual dhe jo normativ të përmbajtjes së tij. Ky vendim, sipas tij, përmban rregulla konkrete e masa me karakter organizativ që përcaktojnë vetëm formën e kontrollit parlamentar dhe nuk vendos rregulla me karakter të përgjithshëm dhe abstrakt, karakteristikë kjo e ligjeve dhe akteve të tjera juridike që i nënshtrohen kontrollit kushtetues.

Gjykata Kushtetuese çmon se nuk mund të përjashtojë apriori nga kontrolli kushtetues çdo akt me natyrë individuale. Megjithatë, ajo ka pranuar se nuk ka juridiksion për akte të kësaj natyre kur zhvillon gjykim abstrakt dhe veçanërisht në vështirësi të formulimit të dispozitës së shkronjës “c” të nenit 131 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, do të konsiderohet i drejtë pretendimi i subjektit të interesuar për karakterin individual dhe jo normativ të vendimit të sipërcituar dhe, për këtë arsye, kërkesa e iniciuar nga jo më pak se një e pesta e deputetëve duhet rrëzuar për mungesë juridiksioni.

Kërkesa e paraqitur nga jo më pak se një e katërta e deputetëve ka një objekt të ndryshëm në formë nga kërkesa e sipërcituar. Kërkuessit është paraqitur me cilësinë e subjektit në konflikt që pretendon se është cenuar drejtpërdrejt në kompetencat e tij kushtetuese për shkak të vendimmarrjes parlamentare. Kërkesa e pakicës parlamentare, në rastin në shqyrtim, e jo më pak se një e katërtës së deputetëve, për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar për verifikimin e lidhjeve nepotike, konfliktin e interesit dhe përfitimeve pasurore që rrjedhin prej tyre për Kryeministrin, familjarët dhe të afërmit e tij, është refuzuar nga Kuvendi me vendimin nr.60, datë 27.9.2006. Mosmiratimi i kësaj kërkesë, me arsyetimin se një çështje e tillë është ezauruar me vendimin nr.59, datë 18.9.2006, si dhe devijimi i objektit të hetimit dhe shtimi i subjekteve për t’u kontrolluar pa pëlqimin e pakicës, e ka penguar këtë në ushtrimin e kompetencës së saj kushtetuese. Sipas kërkuessit, miratimi i akteve të tilla juridike përbëjnë shkakun kryesor për konfliktin kushtetues të krijuar ndërmjet pushtetit të pakicës parlamentare dhe Kuvendit. Baza juridike së cilës i është referuar kërkuessi, përbëhet nga nenet 77 dhe 131, shkronja “ç” e Kushtetutës, si dhe nga nenet 54, 55 dhe 56 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Përderisa kërkuessi e ka parashtruar çështjen si mosmarrëveshje kompetence ndërmjet pushteteve, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme të analizojë pikësëpari juridiksionin kushtetues mbi çështje të kësaj natyre, në kuptim të nenit 131, shkronja “ç” të Kushtetutës, për të konkluduar edhe për pozitën juridike të subjekteve që iniciojnë këto gjykime.

Zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet pushteteve, si një ndër drejtimet kryesore të drejtësisë kushtetuese, është trajtuar në jurisprudencën kushtetuese shqiptare. Nëpërmjet

disa vendimeve,¹ Gjykata Kushtetuese e ka zhvilluar këtë doktrinë, duke konsoliduar njëkohësisht qëndrimin e saj se dispozita e shkronjës “ç” të nenit 131 të Kushtetutës përfshin jo vetëm mosmarrëveshjet që lindin në sferën e ndarjes klasike të pushteteve (ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor, si dhe pushtet qendror e qeverisje vendore), por edhe ato që mund të lindin midis organesh a subjektesh që nuk bëjnë pjesë, në mënyrë të përcaktuar e kategorike në secilin prej tyre.

Një mosmarrëveshje kompetence që paraqitet për zgjidhje para Gjykatës Kushtetuese duhet të ketë natyrë kushtetuese, në kuptimin që subjektet e përfshira në konflikt të jenë nga ato që i njeh Kushtetuta dhe që kompetenca e pretenduar të parashikohet si e tillë. Në këtë mënyrë, gjykimi në Gjykatën Kushtetuese përqendrohet pikësisht në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencës për sa i takon funksioneve të nivelit kushtetues, duke gjetur dhe cilësuar të papajftueshëm me Kushtetutën shkakun vendimtar që ka sjellë lindjen e mosmarrëveshjes.

Në çështjen në shqyrtim, jo më pak se një e katërta e deputetëve, si subjekt kushtetues, pretendon se i është mohuar kompetenca për ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar. Gjykata Kushtetuese, në vendimin për interpretimin përfundimtar të nenit 77 të Kushtetutës,² ka konkluduar si për statusin kushtetues me të cilin paraqitet pakica parlamentare, ashtu edhe për natyrën juridike të së drejtës së kësaj të fundit për ngritjen e komisionit hetimor.

Gjykata Kushtetuese e cilëson si “kompetencë kushtetuese” të drejtën e pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar. Duke e veshur një të katërtën e deputetëve me këtë pushtet, Kushtetuta “... institucionalizon një lloj tjetër autoriteti kushtetues, që njihet si pushtet i pakicës parlamentare”, që realizohet “... në mënyrë të pavarur...” dhe që është “...i pakufizuar nga vullneti i shumicës”. E drejta e kontrollit hetimor i është njohur pakicës parlamentare, e cila, duke i pasur të kufizuara mjetet, “mund ta shndërrojë atë në një instrument të fuqishëm kushtetues”.

Kushtetuta “... ka evituar, veçanërisht për ngritjen e komisionit, kalimin e çështjes në procedurat e zakonshme të votimit” dhe, mbi këtë bazë, Kuvendi “... ka detyrimin që të mos e diskutojë ngritjen e komisionit” kur kjo kërkohet nga pakica parlamentare. Objekti i hetimit “... nuk mund të reduktohet nga Kuvendi deri në atë masë sa t’ia bëjë të pamundur komisionit kryerjen e veprimtarisë”. Prandaj, jurisprudenca e ka pranuar tashmë se “... e drejta e pakicës për të disponuar mbi objektin e hetimit e kufizon kompetencën e shumicës për të ndryshuar këtë objekt pa pëlqimin e pakicës, me përjashtim të rasteve, kur nga qëllimi dhe objekti i hetimit konstatohen se preken parimet kushtetuese.”³

Mbi bazën e këtyre konkluzioneve të nxjerra nga jurisprudenca e saj, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme të ritheksojë se çdo organ juridiksional, qoftë si institucion a organ pushteti, në kuptimin klasik administrativ të tij, apo dhe si subjekt që ushtron funksionet në një situatë pavarësie të plotë të garantuar nga Kushtetuta, konsiderohet i legjitimuar për të qenë palë në mosmarrëveshje pushtetesh.

Duke iu referuar rastit në shqyrtim, konstatohet se ndërmjet pakicës parlamentare (jo më pak se një e katërta e deputetëve) nga njëra anë dhe Kuvendit nga ana tjetër, ka lindur në realitet një mosmarrëveshje për ushtrimin e së njëjtës kompetencë kushtetuese. Kushtetuta i njeh pakicës parlamentare kompetencë hetimi, pengimi i së cilës përbën konflikt kushtetues kompetence. Vendimi i Kuvendit nr.60, datë 27.9.2006 për mosmiratimin e kërkesës së 35 deputetëve për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar, ka cenuar këtë të drejtë kushtetuese të pakicës parlamentare. Gjykata Kushtetuese konstaton se kompetenca për të cilën ka lindur konflikti, është me natyrë kushtetuese dhe e parashikuar drejtpërdrejt prej Kushtetutës, gjë që përbën argument të mjaftueshëm për të legjitimuar pakicën parlamentare si pjesë e Kuvendit, në këtë gjykim kushtetues.

Sipas Kushtetutës, Kuvendi dhe pakica parlamentare kanë të drejtën e ngritjes së komisionit hetimor dhe asnjëri prej tyre nuk mund të pengohet në ushtrimin e kësaj prerogative kushtetuese. Gjykata Kushtetuese rithekson se ngritja e komisionit hetimor parlamentar bëhet e detyrueshme kur kërkohet nga pakica parlamentare në cilësinë e subjektit kushtetues. Në rastin e dhënë, përderisa nuk janë ngritur pretendime për cenime të parimeve kushtetuese në objektin e hetimit, Kuvendi nuk duhej

¹ Vendimet nr.26, datë 4.12.2006 dhe nr.29, datë 21.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

² Vendimi nr.18, datë 14.5.2003, në “Vendime të Gjykatës Kushtetuese 2003”, Tiranë, faqe 84.

³ Të gjitha citimet janë shkëputur nga Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.18, datë 14.5.2003. Përmbledhje e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, viti 2003, faqe 84.

që një kërkesë të tillë t'ia nënshtrohte procedurës së vendimmarrjes. Për rrjedhojë, vendimi i Kuvendit, vetëm për sa i takon refuzimit që i bën kërkesës së pakicës për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar, nuk është në pajtueshmëri me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Grupi prej jo më pak se një e katërta e deputetëve ankohet edhe ndaj vendimit të Kuvendit nr.59, datë 18.9.2006, sepse pikërisht ky vendim ka shërbyer si argument për të mohuar kërkesën e tij për ngritjen e komisionit hetimor. Lidhja që vetë Kuvendi i Shqipërisë ka konstatuar ndërmjet arsyes së refuzimit të kërkesës së grupit prej jo më pak se një të katërtës së deputetëve për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar dhe objektit të njëjtë e tërësisht të ezauruar të hetimit në vendimin nr.59, datë 18.9.2006, e bën të domosdoshme për Gjykatën Kushtetuese analizën e hollësishme të shkaqeve që kanë krijuar mosmarrëveshjen e kompetencës ndërmjet dy subjekteve kushtetuese.

Duke analizuar situatën juridike të krijuar, situatë e karakterizuar nga gjendja konfliktuale, rezulton se shkaku i lindjes së mosmarrëveshjes ndërmjet jo më pak se një të katërtës së deputetëve dhe Kuvendit në ushtrimin e kompetencave kushtetuese të tyre duhet kërkuar pikërisht në dy vendimet e sipërcituara. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese, në çështjen në shqyrtim, mbetet zgjidhja e kësaj mosmarrëveshje kompetence me anë të eliminimit të shkaqeve që e kanë lindur atë, si dhe shqyrtimit të kushtetutshmërisë së objektit të hetimit, qoftë në vendimin nr.59, datë 18.9.2006, ashtu dhe në vendimin nr.60, datë 27.9.2006 të Kuvendit.

Sa i përket qëndrimit që duhet mbajtur për të vlerësuar kushtetutshmërinë e një komisioni hetimor, Gjykata Kushtetuese është shprehur në vendimin e saj nr.18, datë 14.5.2003, në të cilin ajo ka tërhequr vëmendjen, ndërmjet të tjerash, për parimet që duhen respektuar gjatë fazave të realizimit të qëllimit të hetimit: në çastin e formulimit të objektit, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së komisionit dhe në hartimin e konkluzioneve përfundimtare të hetimit.

Kuvendi mund të ushtrojë hetim nëpërmjet komisioneve të tij edhe mbi zyrtarët e institucioneve kushtetuese për çështje të veçanta, të cilat përfshihen brenda funksionit të kontrollit parlamentar dhe që lejohen nga Kushtetuta, por një hetim i tillë nuk mund të zëvendësojë apo të dublojë prerogativat e organeve të tjera të pavarura. Kuvendi mund të ngrejë komision hetimor kur përmbushen të paktën tre kushte kryesore: 1) çështja duhet të ketë të bëjë me funksionin ligjvënës dhe funksione të tjera për të cilat ai është i autorizuar të marrë masa ligjore; 2) objekti i hetimit duhet të fokusohet në çështje ose në subjekte konkrete; 3) duhet të ekzistojnë të dhëna ose indicie të mjaftueshme që dëshmojnë për ekzistencën e një çështje, për të cilën është i nevojshëm hetimi. Në rastin në shqyrtim, çështja shtrohet për të konkluduar nëse objekti i hetimit të vendimit nr.59, datë 18.9.2006 të Kuvendit i përmbush ose jo kërkesat thelbësore që i nevojiten një hetimi parlamentar kushtetues.

Përkufizimi i objektit të hetimit përbën hapin e parë nga ku do të përcaktohet edhe ecuria e mëtejshme e hetimit parlamentar. Objekti i hetimit, i parashtruar në mënyrë të qartë e të saktë, duhet të përmbajë fakte ose tërësi faktesh, nga të cilat merr shkas hetimi parlamentar dhe shpjegon se çfarë hetohet. Veç kësaj, objekti i hetimit duhet të jetë i përcaktuar në mënyrë të mjaftueshme, kusht ky që kërkohej për respektimin e parimit të shtetit të së drejtës, respektimit të të drejtave themelore, të parimit të ndarjes së pushteteve si dhe të kompetencave të kufizuara që disponon një komision hetimor.

Qëndrimet, tashmë të konsoliduara, që ka mbajtur jurisprudenca kushtetuese shqiptare për domosdoshmërinë e respektimit të parimeve dhe koncepteve kushtetuese gjatë kryerjes së hetimeve parlamentare, janë fokusuar drejt argumentit se funksioni kontrollues i Kuvendit nuk mund të qëndrojë jashtë natyrës së tij ligjvënëse. Ushtrimi i funksionit të hetimit parlamentar nuk mund të realizohet duke ndërhyrë në veprimtarinë e organeve të pavarura. Natyra e hetimit parlamentar nuk është e njëjëllojtë dhe nuk mund të barazohet me hetimin që realizojnë në bazë të ligjit organet e tjera të pavarura apo të specializuara për kryerjen e një funksioni të tillë. Nuk mund të konsiderohet se është në përputhje me parimet kushtetuese një hetim i iniciuar që nuk i përket veprimtarisë së legjislativit dhe qëllimeve të saj. Ky instrument i rëndësishëm nuk mund të përdoret në mënyrë abuzive dhe tej hapësirës kontrolluese që Kushtetuta i njeh Kuvendit.

Duke e krahasuar objektin e hetimit parlamentar me objektin e disa ligjeve të posaçme që veprojnë në fushën e kontrollit të deklarimit të pasurive dhe të parandalimit të konfliktit të interesave të të zgjedhurve dhe të disa funksionarëve publikë, Gjykata Kushtetuese nuk konstaton ndonjë dallim cilësor ndërmjet veprimtarisë së komisionit hetimor parlamentar dhe veprimtarisë së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurive. Në këtë mënyrë, objekti i hetimit, sipas vendimit të sipërcituar të

Kuvendit, nuk e ndalon dublimin dhe as shmangien e një institucioni shtetëror të pavarur, siç është ky Inspektorat, në ushtrimin e kompetencave ligjore të tij nga një instrument i një pushteti tjetër. Për rrjedhojë, një hetim i tillë e deformon natyrën kushtetuese të funksionit të kontrollit parlamentar.

Kushtetutshmëria e objektit të hetimit parlamentar varet gjithashtu nga prania apo përfshirja në të e konceptit kushtetues “*çështje e veçantë*”, si edhe nga metodat dhe instrumentet që i vihen në dispozicion komisionit për të realizuar qëllimin për të cilin është krijuar. Sipas qëndrimit të mbajtur nga jurisprudenca janë kushtetuese, “*çështjet e hetimit të trajtuara në aspektin e kontrollit dhe të zbatimit të ligjit, të njohjes e verifikimit të një ngjarjeje, a veprimtarie dhe që nxisin iniciativat për propozime e miratime ligjesh, me qëllim parandalimin e fenomeneve negative për shoqërinë e shtetit dhe nxjerrjen e përgjegjësive institucionale, përfshihen në konceptin kushtetues çështje e veçantë.*”¹

Në këtë mënyrë, objekti i hetimit të komisionit parlamentar, i fokusuar në një çështje të veçantë dhe jo në një çështje të përgjithshme, evidenton njëkohësisht edhe qëllimin e hetimit parlamentar. Nga kjo pikëpamje, Gjykata Kushtetuese thekson se komisioni hetimor parlamentar ngrihet kur ekziston në fakt çështja e veçantë dhe jo për të parë nëse mund të zbulohet ose të gjendet ndonjë e tillë në të ardhmen.

Pas analizës që i bëhet vendimit nr.59, datë 27.9.2006, arrihet në përfundimin se Kuvendi nuk ka arritur të përcaktojë qartësisht dhe me të gjitha elementet kushtetuese objektin e hetimit të komisionit parlamentar, nga ku do të mund të ushtrohej ndikim i drejtpërdrejtë në realizimin e funksioneve parësore të legjislativit. Mbi këtë bazë, Gjykata Kushtetuese nxjerr konkluzionin se objekti i hetimit, ashtu siç parashikohet në këtë vendim të Kuvendit, nuk përputhet me funksionin dhe qëllimet e kontrollit parlamentar.

Duke paraqitur të njëjtat argumente, Gjykata Kushtetuese do të vlerësonte papajtueshmërinë kushtetuese edhe të objektit të komisionit hetimor parlamentar për verifikimin e lidhjeve nepotike, konfliktin e interesit dhe përfitimeve pasurore që rrjedhin prej tyre për Kryeministrin, familjarët dhe të afërmit e tij, nismë e cila nuk është refuzuar nga Kuvendi për motivet kushtetuese të sipërcituara, por për një arsye antikushtetuese. Prandaj, shfuqizimi nga Gjykata Kushtetuese i vendimit nr.60, datë 27.9.2006 të Kuvendit, nuk ligjëron të drejtën e pakicës parlamentare që me të njëjtin objekt hetimi të kërkojë ngritjen e këtij komisioni parlamentar. Është detyrë e Kuvendit, ashtu si edhe e pakicës parlamentare, që në ndërmarrjen e nismave për ngritjen e komisioneve hetimore parlamentare të kenë si orientim kryesor respektimin e parimeve kushtetuese, si dhe të qëndrimeve të mbajtura në jurisprudencën e kësaj Gjykate.

Mbështetur në argumentet e nxjerra nga kjo analizë, si edhe duke ballafaquar objektin e hetimit parlamentar me standardet dhe parimet kushtetuese të trajtuara gjerësisht në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese konkludon se:

- e drejta e pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor nuk mund të mohohet, të kufizohet apo të deformohet nëpërmjet vendimmarrjes së shumicës parlamentare;
- ngritja e komisionit hetimor prej shumicës parlamentare nuk duhet të ndalojë shprehimisht dhe as në mënyrë të nënkuptuar komisionin e kërkuar dhe të ngritur nga pakica parlamentare;
- shkak i lindjes së mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet subjekteve të sipërcituara duhet kërkuar te mohimi i kompetencës kushtetuese të pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor me argumentin jokushtetues të Kuvendit për ezaurimin e kësaj kërkesë;
- mosekzistenca e indicies dhe e shkakut të përligjur për argumentimin e konceptit kushtetues “*çështje e veçantë*” ka sjellë shtrirjen e skajshme të rrethit të subjekteve dhe të periudhës kohore të hetimit dhe për rrjedhojë, e ka bërë të paqartë e të papërcaktuar objektin e hetimit të komisionit parlamentar;
- deformimi i kompetencës kushtetuese të Kuvendit për të hetuar në fusha apo çështje që nuk i përkasin drejtpërdrejt funksionit të kontrollit parlamentar, ka dubluar, zëvendësuar apo shmangur veprimtarinë e institucioneve të pavarura në ushtrimin e kompetencave të tyre ligjore.

PËR KËTO ARSYE;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 77; 131 shkronja “ç”; 134, pika 1, shkronja “c” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenet 54, 55, 56 dhe 72

¹ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.18, datë 14.5.2003, Vendime të Gjykatës Kushtetuese 2003, faqe 84.
1384

të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës të jo më pak se një të katërtës së deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë.
 2. Zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës të krijuar ndërmjet jo më pak se një të katërtës së deputetëve dhe Kuvendit të Shqipërisë, duke konkluduar se e drejta e pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor është një kompetencë kushtetuese dhe e detyrueshme për t’u respektuar dhe që nuk mund të cenohet nëpërmjet vendimmarrjes së shumicës parlamentare, me përjashtim të rasteve të mosrespektimit të parimeve kushtetuese.
 3. Të deklarojë të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si shkak për lindjen e mosmarrëveshjes së kompetencës, vendimin nr.60, datë 27.9.2006 të Kuvendit të Shqipërisë.
 4. Të deklarojë të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë objektin e hetimit në vendimin nr.59, datë 18.9.2006 të Kuvendit të Shqipërisë.
 5. Rrëzimin e kërkesës të jo më pak se një të pestës së deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë për mungesë të juridiksionit kushtetues.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.